

# VËSHTRIM PËRTEJ URËS SË MITROVICËS NJË PAKO PROPOZIM "AHTISAARI PLUS"

Prishtinë, tetor 2008

Ky projekt është përkrahur nga Swiss Cooperation Office, Kosovë

Përgatitur nga: Ilir Deda dhe Lulzim Peci

Copyright © 2008 nga KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, vendoset në ndonjë sistem ripërtëritës, apo të bartet në çfarëdo qoftë trajte apo përmes çfarëdo qoftë mjetesesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, inçizuese apo të tjera, pa lejen paraprake në trajtë të shkruar nga botuesi. Për këtë qëllim ju lutemi kontaktoni në [info@kipred.net](mailto:info@kipred.net), apo në +381 38 555 887.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave  
Kodra e Diellit, Rruga 3, Lam. 39  
Prishtinë, Kosovë (UNMIK)  
Phone&Fax: + 381 38 555 887  
[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

## I. Hyrje

Kosova, dhe në veçanti pjesa e saj veriore, janë duke hyrë në një status quo të ri për shkak të një rikonfigurimi të çrregullt të pranisë ndërkombëtare në këtë territor. Ky çrregullim ka ndikim të drejtpërdrejtë në terren, dhe nëse nuk zgjidhet, në një të ardhme të afërt mund të shpjerë në pasoja të paparapara. Kosova Veriore ka qenë një shembull i zymtë i rikonfigurimit kaotik, si pasojë e kundërshtimeve të Beogradit, mungesës së vullnetit politik të Brukselit dhe qëndrimeve obstruktive të Kombeve të Bashkuara. Për aq sa veriu do të mbetet një “pikë e nxehtë” e pazgjidhje e Kosovës, radikalizmat dhe dëshpërimet e përhershme, si të shqiptarëve, ashtu edhe serbëve, do të kenë hapësirë të mjaftueshme. Qeveria e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare e kanë kaluar pothuaj një dekadë të përqendruara në urën e Mitrovicës dhe në menaxhimin e konfliktit në vend se të ofrojnë zgjidhje në trajtë stimulimesh zhvillimore për Kosovën dhe në veçanti për zonat e banuara me serbë. Sa i përket krijimit të hapësirës për një kohezion shoqëror dhe për pajtimin ndëretnik në Kosovë, këto politika përfunduan në një mënyrë katastrofike. Mitrovica Veriore, një zonë kjo me gjithsej 1,5 kilometra katrorë, kontrollohet nga disa dhjetra agjentë të fshehur të Agjencionit Informativ Serb të Sigurisë (BIA), të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP) dhe të grupeve kriminale të sponsoruara nga Beogradi, dhe vullneti i serbëve lokal për të bashkëpunuar me shqiptarët bllokohet me shpejtësi përmes kërcënimeve dhe presioneve më të vrazhda. Në të njëjtën kohë, mosveprimi i bashkësisë ndërkombëtare në veri, strukturat paralele serbe i ka shndërruar në mit.

Vendosja e ngadalshme e misionit të sundimit të ligjit të Unionit Evropian (EULEX) dhe mungesa e qartësisë për fushën e veprimit të tij, dalngadalë janë duke e zvogëluar autoritetin dhe kredibilitetin e operacionit më të madh të Politikës Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (ESDP) i cili është ndërmarrë ndonjë herë nga Brukseli. Po të vazhdojë ky trend i mungesës së përkushtimit dhe të vullnetit, është rreziku që EULEX-i, madje edhe para se të bëhet në tërësi operacional, do të shndërrohet në një mision të padobishëm, si për shqiptarët, ashtu edhe për serbët. Misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK) formalisht e ka filluar rikonfigurimin dhe pakësimin e personelit të vet, mirëpo ky ka qenë obstruktiv ndaj vendosjes së plotë të EULEX-it në terren. EULEX-i është i ngujuar midis refuzimit të UNMIK-ut për ta ndihmuar vendosjen e tij, dhe mungesës së vullnetit politik në Bruksel për të ndërmarrë hapa energjik për funksionalizimin e misionit të tij për shkak të frikës së konfliktit me strukturat serbe të sponsoruara nga Beogradi në veri të Kosovës. Gjithashtu, Brukseli praninë e EULEX-it në Kosovën veriore dhe në zonat e tjera serbe është duke e negociuar me Beogradin, një palë kjo e cila integrimin në EU është duke e kërkuar në të njëjtën kohë që misionin e këtij klubi është duke e sabotuar në një mënyrë aktive. Kërkimi i lejes së Beogradit për vendosjen e EULEX-it në zonat e banuara me serbë e sinjalizon sovranitetin e Serbisë mbi një pjesë të Kosovës, dhe Beogradit ia jep një “veto” efikase ndaj politikës së Brukselit lidhur me Kosovën. Njëkohësisht, Serbia është duke e vazhduar forcimin e kontrollit dhe të kërcënimeve të veta ndaj serbëve të Kosovës dhe obstruksionin e funksionalitetit të Kosovës.

Serbët e Kosovës janë duke hyrë në një faqë të re të pasigurisë sa i përket të ardhmes së tyre. Deklaratat që Tadiqi i ka bërë kohëve të fundit për ndarjen e Kosovës, në mesin e serbëve nëpër enklava janë interpretuar si një shenjë e braktisjes nga Beogradi. Në të njëjtën kohë, Serbia është duke i rehabilituar dhe fuqizuar anembanë Kosovës përkrahësit e mëparshëm të Partisë Socialiste të Serbisë (SPS) të Millosheviqit. Këta kuadro janë duke ushtruar diktaturë mbi serbët nëpër enklava përmes Qendrës Koordinuese të Kosovës (CCK) të Serbisë, e cila është e vendosur në Graçanicë.<sup>1</sup> Serbët e Kosovës mbeten të dobët dhe pa ndonjë udhëheqësi autentike e cila do t'i mbronte interesat e tyre dhe do t'i krijonte kushtet për ndërtimin e një jete prosperuese në Kosovë. Në përgjithësi, gatishmëria serbe për të bashkëpunuar me Qeverinë e Kosovës është rritur, mirëpo ata Prishtinën ende nuk e shohin si një partner të sigurtë. Ata vazhdojnë të tregojnë elasticitet për ta rezistuar presionin politik të Beogradit, mirëpo janë në pritje të ofertave të prekshme nga Prishtina dhe nga misionet ndërkombëtare që janë në terren. Strukturat paralele serbe serbëve të Kosovës u ofrojnë vetëm mbijetesë, dhe ato nuk janë në gjendje të krijojnë kushte për zhvillimin e tyre. Kosova Veriore është një zonë *par excellence* ku kontrolli i Serbisë nuk ia doli t'i përmirësojë jetët e serbëve të Kosovës. Perspektivat për Serbinë për të ofruar zhvillim nuk ekzistojnë pas pavarësisë së Kosovës.

Qeveria e Kosovës e tregon një mungesë të nismave serioze politike për menaxhimin e situatës së tashme dhe të qasjes ndaj popullatës serbe. Ndaras nga përkushtimi i 2 milion eurove për t'i ndihmuar shqiptarët në veri, udhëheqësia në Prishtinë nuk e ka treguar asnjë skemë gjithëpërfshirëse për ta gjetur ndonjë zgjidhje të qëndrueshme për këtë zonë. Në vend të kësaj, ajo vazhdon ta lëjë problemin në veri në mëshirën e bashkësisë ndërkombëtare.

Zyra Ndërkombëtare Civile (ICO) ka treguar aftësi udhëheqëse në përgatitjen e terrenit për zbatimin e propozimit të Ahtisaarit, mirëpo puna e saj ka pengesa të pandërprera për shkak të mungesës së përkrahjes nga EU-ja. Pos kësaj, disa organizata ndërkombëtare në Kosovë, ICO-në e konsiderojnë si një institucion "ilegal." Testim për suksesin e ICO-së do të jetë jetësimi i decentralizimit dhe krijimi i komunave të reja, dhe kjo ka të bëjë veçanërisht lidhur me krijimin e komunës së re të Mitrovicës Veriore. Pa një përkrahje të qartë, konkrete dhe të plotë të bashkësisë ndërkombëtare, perspektivat për suksesin e ICO-së mbeten të zymta.

1,5-kilometërshi katror i pafrenuar mund të çojë në një dështim të plotë jo vetëm të planit të Ahtisaarit, por edhe i të tërë përfshirjes ndërkombëtare në Kosovë. Për aq sa situata në veri të mbetet e braktisur, e çiftuar me idenë gjithnjë të pranishme të ndarjes, kushtet për radikalizëm etnik dhe ekstremizëm fetar do të bëhen gjithnjë e më të favorshme. Shqiptarët e Kosovës ende mbajnë shpresë që situata do të përmirësohet falë pranisë së

---

<sup>1</sup> Selia e Qendrës Koordinuese të Kosovës (degë kjo e Ministrisë për Kosovën dhe Metohinë të Qeverisë serbe), është bartur në Graçanicë më 17 shtator 2008. Kjo udhëhiqet nga Zvonimir Steviq, ish-prefekt i Prishtinës gjatë viteve 1990 dhe anëtar i SPS-it. Gjatë të tërë shtatorit 2008, Steviq është takuar me të gjithë udhëheqësit e fshatrave në enklavat serbe, duke u thënë atyre që t'i nënshtrohen vullnetit të shtetit serb. Serbët lokalë janë ankuar për mosbesimin që ata e kanë për liderët e tyre të emëruar, gjë të cilën Steviq e ka shpërfillur (intervistë e KIPRED-it me një zyrtar të UNMIK-ut, 24 shtator, 2008, Prishtinë).

madhe ndërkombëtare, dhe që Kosova do të shndërrohet në një shtet funksionues, gjë kjo të cilën Beogradi dëshiron ta pamundësojë madje edhe përmes flijimit të popullatës serbe në jug të lumit Ibër.

Përmes kësaj përmbledhjeje politike KIPRED-i përpiqet ta hetojë zgjidhjen e mundshme për Kosovën veriore, e cila shkon përtej ditorisë mbizotëruese të rëndomtë që problemet në veri mund të zgjidhen përmes modeleve të stilit të Brçkos, Mostarit e Sllavonisë Lindore, apo të ndarjes përmes ndonjë “kompromisi historik” midis Prishtinës dhe Beogradit. Prandaj KIPRED-i edhe e propozon një zgjidhje “Ahtisaari Plus” me faza tri-shkallëshe, e cila do të ofrojë mbështetje për funksionalitetin e shtetit dhe edhe për zhvillim të qëndrueshëm, si për shqiptarët, ashtu edhe për serbët e Kosovës veriore.

## **II. Kosova Veriore pas pavarësisë**

### **a) Situata në zonat e dominuara nga serbët**

Veriu i Kosovës ka hyrë në një periudhë të mungesës së plotë të ligjshmërisë pas shpalljes së pavarësisë. Privatisht, zyrtarët ndërkombëtarë në Prishtinë dhe në Mitrovicë këtë zonë e përshkruajnë si një “El Dorado” të Kosovës. Kjo është pasojë e një dështimi katastrofik njëdekadësh të UNMIK-ut, të Forcës së Kosovës (KFOR) dhe të Prishtinës për ta jetësuar sundimin themelor të ligjit dhe sigurinë për njerëzit në këtë zonë. Në vend të kësaj, qëllimi kryesor ka qenë në ruajtjen e status quosë, me një përqendrim të veçantë në urën e lumit të Ibrit e cila e ndan Mitrovicën. Gjatë kohës kur serbët ishin duke u zhvendosur dhe dëbuar nga zonat e mëdha urbane në jug të Ibrit, në Kosovë, më 1999 dhe 2000, Mitrovica veriore konsiderohej si i vetmi vendbanim i largët urban për serbët e Kosovës, dhe shumica e shqiptarëve u dëbuan nga pjesa veriore e qytetit. Në këtë zonë të Kosovës, shërbimi inteligjent serb dhe MUP-i janë duke vepruar haptas që nga qershori 1999, duke e shkelur qartë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB dhe po ashtu edhe dispozitat e Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës. Këto struktura kanë ofruar përkrahje për elementet kriminale në veri, të cilat në një mënyrë vendimtare i kanë bërë obstrukcion të gjitha nismave për bashkëpunim ndëretnik dhe për t’i mbajtur marrëdhëniet ndëretnike në një nivel më të lartë. Serbët e Mitrovicës mbeten peng të politikanëve të korruptuar që fuqinë e tyre e nxjerrin nga përkrahja e Beogradit dhe mungesa e vullnetit politik të KFOR-it dhe UNMIK-ut për ta jetësuar sundimin e ligjit.

UNMIK-u e ka ndërtuar një partneriteti të çuditshëm me udhëheqësit e serbëve të veriut të Kosovës, duke i konsideruar ata si përfaqësues legjitim të serbëve të Kosovës. Këta liderë shfrytëzojnë kërcënimet dhe shqetësimet më të vrazhda për ta pohuar mbizotërimin dhe kontrollimin e tyre mbi njerëzit e tyre. Gerard Galluci, administratori në largim e sipër i UNMIK-ut i Mitrovicës, ka qenë në veçanti i spikatur si njëra nga figurat më destruktive dhe obstruktive që ka penguar çfarëdo nismash për masa të normalizimit në veri. Kjo ka filluar me shpërfilljen e informatave të inteligjencës, të dhëna nga Selia e UNMIK-ut disa ditë para shpalljes së pavarësisë, mbi synimet e radikalëve serbë për t’i shkatërruar vendkalimet kufitare 1 dhe 31 me Serbinë.<sup>2</sup> Galluci parandaloi çfarëdo

<sup>2</sup> Intervistë e KIPRED-it me një zyrtar të lartë të UNMIK-ut, 24 shtator 2008, Prishtinë.

masash paraprake duke pohuar që të dhënat e tilla të inteligjencës ishin false, dhe që serbët nuk do të rebeloheshin.

Postet kufitare u dogjën më 19 shkurt 2008, dhe që nga atëherë shërbimi i doganave në veri nuk funksionon, gjë që përcillet me një rritje dhe lulëzim të drejtpërdrejtë të aktiviteteve ilegale ekonomike dhe të krimit të organizuar në këtë zonë dhe jashtë saj. Këto aktivitete kriminale fillojnë në Beograd dhe përfundojnë në Prishtinë.<sup>3</sup> Doganat e Kosovës u zhvendosën në jugun e Mitrovicës, duke e hapur kësisoji rrugën për një kontrabandë të përhapur dhe për lulëzimin e krimit ekonomik. Mungesa e regjimit të mirëfilltë kufitar ka rezultuar me humbje mujore të Kosovës prej 3 milionë €<sup>4</sup> ndërkohë që Serbia i humb nga një milion € çdo ditë.<sup>5</sup> Në shtator 2008 Serbia e ka futur një taksë për karburante në pikat e saj kufitare që hyjnë në Kosovë. Për më tepër, Beogradi ka lëvizur në drejtim të tregtimit për ngritjen e sërishme të doganave në anën e Kosovës, duke dashur ta ndajë veriu si një entitet të veçantë.<sup>6</sup> Serbia kushtëzon që të gjitha të hyrat e grumbulluara në vendkalimet kufitare 1 dhe 31 të menaxhohen nga UNMIK-u nëpërmjet një “logarie speciale” në Kosovë dhe t’i dedikohen ekskluzivisht zhvillimit të zonave serbe në veri.<sup>7</sup> Mirëpo serbët në jug nuk pajtohen me një rregullim të tillë. Përkrahësi më i fuqishëm për ngritjen e doganave dhe të pranisë së EULEX-it anembanë Kosovës është Rada Trajković, një udhëheqëse serbe e Kosovës qendrore. Ajo është e bindur që popullata serbe do të përfitojë nga EULEX-i, duke e përkrahur në mënyrë strategjike një prani të vetme ndërkombëtare anembanë Kosovës për ta parandaluar ndarjen, mirëpo ajo e ka një ndikim të kufizuar në veri.<sup>8</sup>

Serbët në Mitrovicën e veriut nuk e kanë një udhëheqësi të qartë. Madje as “zgjedhjet komunale” të organizuara nga Serbia më 11 maj 2008 nuk e dhanë një zë të qartë për ta. Ndërkohë që Partia Demokratike (DS) e Boris Tadiqit i fitoi zgjedhjet në Serbi, në Mitrovicë, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq fituan Partia Radikale Serbe (SRS) dhe Partia Demokratike e Serbisë (DSS).<sup>9</sup> Para se në Beograd të krijohet qeveria DS – Partia Socialiste e Serbisë (SPS), Koshtunica dhe Samargjiq bënë trysni për themelimin e “Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë.”<sup>10</sup> Tadiqi fillimisht e kundërshtoi krijimin e Kuvendit, por më vonë u dha

---

<sup>3</sup> Intervistë e KIPRED-it me një zyrtar të lartë qeveritar të Kosovës, 9 tetor 2008, Prishtinë.

<sup>4</sup> “Marrëveshjet i duan në tetor”, Express, 14 tetor 2008, fq. 4.

<http://www.gazetaexpress.com/pdf/1306.pdf>.

<sup>5</sup> “Srbija gubi milion evra zbog sverca na severu KiM”, Blic, 23 gusht 2008.

<http://www.blic.co.yu/politika.php?id#54080>.

<sup>6</sup> Intervistë e KIPRED-it me një zyrtar të lartë të ICO-së. 9 tetor 2008.

<sup>7</sup> “Marrëveshjet i duan në tetor”, Express, 14 tetor 2008, fq. 4.

<http://www.gazetaexpress.com/pdf/1306.pdf>.

<sup>8</sup> Intervistat e KIPRED-it me Rada Trajković, shtator/tetor 2008.

<sup>9</sup> Kuvendi komunal i Mitrovicës: SRS 11, DSS 9, DS 6, SPS 2, të tjerët 2.

Kuvendi komunal i Zveçanit: SRS 9, DSS 8, Këshilli Kombëtar Serb (SNV) 4, SPS 3, të tjerët 3.

Kuvendi komunal i Zubin Potokut: DSS 19, SPS 9, SRS 3.

Kuvendi komunal i Leposaviqit: SRS 10, DSS 8, DS 4, SPS 3, SNV 3, të tjerët 4.

<sup>10</sup> “Kuvendi” u themelua më 28 qershor 2008. Presidenti i këtij trupi është Radovan Niçiq i SRS, dhe zëvendës të tij janë Marko Jakshiq i DSS dhe Srgjan Nikoliq i SRS.

udhëzim anëtarëve të DS-it që t'i bashkangjiten.<sup>11</sup> Ndërkohë që SRS dhe DSS e kontrollojnë Kuvendin, DS dhe G17 e kontrollojnë Ministrinë për Kosovë e Metohi, me Goran Bogdanoviqin si ministër, dhe Oliver Ivanoviqin si sekretar i shtetit. Pra, Tadiqi i kontrollon financat, ndërkohë që Koshtunica dhe SRS e kontrollojnë pamjen politike në veri. Edhe përkundrejt indikacioneve nga DS dhe G17 që liderët radikalë serbë në veri si Marko Jakshiq dhe Milan Ivanoviq do të arrestohen për shpërdorimin e fondeve të Beogradit të dedikuara për serbët e Kosovës, hapat për një veprim të tillë janë ndalur nga autoritetet më të larta në Beograd.<sup>12</sup> Serbia dëshiron ta shfrytëzojë këtë mungesë të qartësisë në veri për ta manipuluar vendosjen e EULEX-it, ndërkohë që nuk heq dorë nga plani i Samarxhiqit për një ndarje funksionale të Kosovës. Ky plan shkon dorë për dore me deklaratimet e Tadiqit mbi ndarjen e Kosovës në të cilën “do të fitojnë të dyja palët”, duke e zbuluar synimin përfundimtar të Beogradit lidhur me Kosovën.<sup>13</sup>

Edhe përkundrejt problemeve politike, marrëdhëniet midis serbëve dhe shqiptarëve të Mitrovicës nuk janë plotësisht të shkatërruara. Po ashtu, rinia e Mitrovicës veriore e shfrytëzon përmirësimin domethënës në lirinë e lëvizjes në Kosovë dhe shpesh herë e viziton Prishtinën.<sup>14</sup> Mirëpo, bashkëpunimi i hapur midis tyre mbetet peng i veprimeve të atypëratyshme të strukturave paralele dhe të zhvendosurve agresivë serbë në veri.

## **b) Qëndrimet e udhëheqësisë shqiptare**

Gjatë nëntë viteve të fundit, udhëheqësia e shqiptarëve të Kosovës ka qenë në tërësi e paaftë për ta zhvilluar një vizion dhe strategji për veriun. Ata kanë preferuar që në përgjithësi t'i shfrytëzojnë konferencat e shtypit për të kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare për të ndërmarrë veprime në veri, në vend që të ofrojnë opsione të zbatueshme politike të vetat për t'u marrë me këtë çështje. Deri më sot, nuk ka patur ndonjë propozim që të ketë ardhur, qoftë nga Prishtina, qoftë nga Mitrovica e jugut, për një zgjidhje të shëndetshme dhe të qëndrueshme, e cila do t'i mirrte parasysh brengat legjitime, si të serbëve, ashtu edhe të shqiptarëve. Ia vlen të përmendet që asnjë qeveri në Prishtinë nuk ka lëvizur për t'i ndihmuar Mitrovicës në tejkalimin e problemeve të grumbulluara, e të cilat shtrihen në brezin e kthimit të personave të zhvendosur, rindërtimit, pajtimit dhe sundimit të ligjit. Për herë të parë Qeveria në Prishtinë ndau 2 milionë € në gusht të vitit 2008, kur Kryeministri Thaçi deklaroi që mjetet financiare do të përdoren për investime në ndërtimin e rrugëve, të kanalizimit dhe të shtëpive.<sup>15</sup> Deri më tani nuk është paraqitur ndonjë plan i qartë publik. Edhe pse ky hap do t'i ndihmonte shqiptarët në veri të cilët ishin të harruar gjatë nëntë viteve të kaluara, mungesa e një

---

<sup>11</sup> Bogdanoviq: DS ulazi u Skupstinu srpskih opstina na Kosovu, Blic, 11 korrik 2008.

<http://www.blic.co.yu/politika.php?id=48951>

<sup>12</sup> Intervistë e KIPRED-it me një udhëheqës të serbëve të Kosovës, 3 tetor 2008.

<sup>13</sup> Tadiq: U novim pregovorima sve opcije, 26 shtator 2008.

<http://www.kim.sr.gov.yu/cms/item/ne#s/rs.html?vie#=#story&id=6405&sectionId=8>

<sup>14</sup> Vërejtjet dhe intervistat e KIPRED-it në Mitrovicën veriore dhe në Prishtinë, korrik-tetor 2008.

<sup>15</sup> Qeveria premton 2 milion euro investime në pjesën veriore të Mitrovicës, 18 gusht 2008,

<http://www.telegrafi.com/?id=468ca=420>.

strategjie gjithëpërfshirëse për t'i inkorporuar serbët është një masë afatshkurtër pa ndonjë vizion dhe strategji afatgjatë.

Praktikisht, Prishtina ia ka lënë përgjegjësinë politike për veriun prefektit të Mitrovicës, ish-Kryeministrit Bajram Rexhepit. Edhe pse Qeveria është duke e ofruar një "trajtim të beneficuar të veçantë" për Mitrovicën e jugut, ajo nuk i ka mobilizuar kapacitetet e veta qeveritare për zgjidhjen e problemeve në veri. Aftësitë vepruese të Rexhepit janë të kufizuara në një nivel taktik, ndërkohë që humbet mundësia për një politikë strategjike dhe një përkrahje e plotë institucionale nga Qeveria. Kësisoj, veprimi i tij ka qenë për keqardhje joefikas në zhvillim, por shumë pozitiv në menaxhimin e situatës politike. Në të njëjtën kohë, Rexhepi e ka humbur mundësinë për t'i mobilizuar kapacitetet e Mitrovicës, përfshirë këtu përkushtimin e qartë të organizatave të shoqërisë civile multietnike. Në veçanti, organizata e quajtur Komuniteti e Ndërton Mitrovicën (CBM) e udhëheqëur nga Valdete Idrizi,<sup>16</sup> ka vepruar në ndërlidhjen e veriut dhe jugut të qytetit përmes masave konkrete për krijimin e besimit. Në disa raste, disa trajtime në veçanti të rëndësishme dhe të ndjeshme të organizatës janë keqtrajtuar politikisht nga ana e udhëheqësisë lokale.<sup>17</sup> Përvoja ka dëshmuar që shoqëria civile mund ta luaj një rol shumë të rëndësishëm në nivelet bazë në të dyja pjesët e Mitrovicës për normalizimin e komunikimit, zbutjen e tendosjeve politike dhe për ta ndihmuar komunitetin për zhvillimin e projekteve që do t'u bijnë përmes vijave etnike. Të gjithë pjesëmarrësit duhet ta marrin seriozisht parasysh këtë fakt për veprimet e tyre të ardhshme.

Edhe përkundrejt retorikës politike, është një komunikim në rrjedhje e sipër midis një numri politikanësh të Kosovës dhe të Qeverisë së Serbisë.<sup>18</sup> Ky komunikim është interpretuar si pozitiv për zgjidhjen e problemeve të imta praktike. Megjithatë, ky dialog mund të tretet shpejt nëse nuk jep rezultate përmbajtësore. Ajo të cilën Prishtina nuk ia del ta kuptojë është se pa një strategji të prekshme e cila do t'i inkorporonte serbët, zërat për ndarje do të bëhen gjithnjë e më të fuqishëm, si në Kosovë, ashtu edhe jashtë. Kjo mund ta sjellë Kosovën në një situatë ku partnerët ndërkombëtarë do ta sugjerojnë ndarjen si plani më i zbatueshëm.<sup>19</sup> Udhëheqësit në Prishtinë nuk e kanë ofruar ndonjë kundër-argument, dhe të shumtën mbështeten në domino-efektin e një ripërkufizimi të plotë të kufijve rajonal. Pasojat e një arranzhimi të tillë do të ishin katastrofike. Kjo do ta tregonte një shkatërrim të plotë të idesë dhe të zbatueshmërisë së shtetësisë së Kosovës; do ta rriste rrëmujën shoqërore brenda-shqiptare, dhe do të çonte në një rënie paralele në besimin ndaj Perëndimit nga një pjesë e popullatës e cila do të kthehej kah radikalizmi fetar.

---

<sup>16</sup> Më 10 mars 2008, përpjekjet e Idrizit u njohën nga Shtetet e Bashkuara, kur ajo u nderua me shpërblimin International Women of Courage të Departamentit të Shtetit:

<http://www.america.gov/st/hr-english/2008/March/20080310114231ajesroom0.6202997.html>

<sup>17</sup> Deklarata e CBM mbi varrezat.

<sup>18</sup> Intervista e KIPRED-it me Bajram Rexhepin, prefektin e Mitrovicës, 10 tetor 2008; me Oliver Ivanoviqin, 12 qershor 2008.

<sup>19</sup> Intervistat e KIPRED-it me zyrtarë dhe diplomatë ndërkombëtarë, korrik, gusht, shtator, tetor 2008.



### c) Problemet lidhur me rikonfigurimin

Rebelimi në Kosovën veriore në shkurt dhe mars 2004 e ka ulur më tutje praninë ndërkombëtare civile në këtë zonë. Për hapjen e sërishme të gjyqit në Mitrovicën veriore, i cili u mbyll në mars 2008 pas përlëshjeve të KFOR-it dhe të Policisë së UNMIK-ut me radikalët serbë, u nevojiten pothuaj tetë muaj.<sup>20</sup> Hapja e sërishme e gjyqit nuk tregon shumë çka mbi perspektivat e zbatimit të sundimit të ligjit në këtë zonë, për shkak të dështimeve të UNMIK-ut në të kaluarën. UNMIK-u u përball po ashtu me probleme të mëdha të brendshme në zbatimin e vetë rikonfigurimit të vet. Ndërkohë që në nivelin qendror në Prishtinë bashkëpunimi i UNMIK-ut me EULEX-in është në përmirësim e sipër, administratori rajonal i UNMIK-ut i Mitrovicës i cili është në largim e sipër, Gerrard Galluci ka qenë egërsisht kundërshtues ndaj vendosjes së EULEX-it në veri. Në vend që serbëve lokalë t'ua shpjegonte përfitimet e misionit të EU-së, Galluci pohonte thjesht që “populli serb e kundërshton këtë,” në të njëjtën kohë kur një numër serbësh nga Mitrovica veriore kanë filluar t'i qasen EULEX-it për punësim dhe janë duke u ofruar banim me qira.<sup>21</sup> Zyrtarë të ndryshëm ndërkombëtarë në Prishtinë dhe në Mitrovicë janë ankuar që Galluci i ka bërë obstrukcion po ashtu projekteve bazike infrastrukturore në veri, dhe i ka kontribuar personalisht ngritjes së tensioneve ndër-etnike. Për më tepër, administratorët komunalë të UNMIK-ut në veri të Kosovës i vizitojnë fshatrat e banuara me shqiptarë dhe kërkojnë nga ta që të bashkëpunojnë me strukturat paralele serbe.<sup>22</sup> Trashëgimia e Gallucit ka qenë një trashëgimi e ruajtjes së status quosë.

EULEX-i i ka të përpunuara planet operationale për vendosjen në veri,<sup>23</sup> mirëpo misioni është i përballur me probleme serioze lidhur me udhëzimet politike që i vijnë nga Brukseli. EU-ja deri më tani nuk e ka dhënë “dritën e gjelbër” për një vendosje efektive të misionit të vet në të tërë territorin e Kosovës për shkak të frikës se grupet e armatosura të sponsoruara nga Beogradi do të përdorin dhunë. Gjithashtu, Brukseli është i penguar nga vendet e ndryshme anëtare, përfshirë këtu edhe disa që e kanë njohur Kosovën, e të cilat janë duke i çuar përpara planet e tyre kur çështja vie tek UNMIK-u, EULEX-i dhe integriteti territorial i Kosovës. Deklarimet publike të Ministrit të Jashtëm suedez, Carl Bildt në përkrahje të dy misioneve ndërkombëtare në Kosovë – EULEX-it për jugun e Ibrit dhe UNMIK-ut për veriun,<sup>24</sup> kanë shkaktuar shqetësime në Prishtinë që ky opsion do të çonte në krijimin e “një vendi, dhe dy sistemeve ligjore,” dhe, së fundi, edhe në ndarjen përfundimtare të Kosovës. Për aq kohë sa Beogradi e sheh që madje as EU-ja nuk

---

<sup>20</sup> Komunikatë shtypi 1740 e UNMIK-ut “UNMIK-u e hap sërish gjyqin në veri të Mitrovicës,” 3 tetor 2008. Më 3 tetor 2008 UNMIK-u e hapi sërish ndërtesën e gjyqit, e cila ka personel, prokurorë dhe gjyqtarë ndërkombëtarë të UNMIK-ut, të cilët do të mirren vetëm me rastet urgjente kriminale, dhe do ta zbatojnë ligjin dhe procedurat e UNMIK-ut.

<sup>21</sup> Intervistat e KIPRED-it me zyrtarë të lartë të ICO-së dhe EULEX-it, 8 dhe 9 tetor, 2008.

<sup>22</sup> Intervistat e KIPRED-it me zyrtarë të ICO-së dhe të komunës së Mitrovicës, 9 dhe 10 tetor, 2008.

<sup>23</sup> Intervistë e KIPRED-it me një zyrtar të lartë të EULEX-it, 8 tetor 2008.

<sup>24</sup> Bildt: Euleks nije uslov za Srbiju, Dnevnik, 13 tetor 2008.

<http://www.dnevnik.co.yu/modules.php?name=Ne#s&file=article&sid=45681>

është në tërësi e bashkuar mbi praninë e EULEX-it anembanë Kosovës, ai do të jetë në gjendje ta zhvillojë lojën e vet duke u mbështetur në këto dallime, ashtu që edhe më tutje t'ia gërmojë themelet rolit të EU-së si një faktor politik dhe i sigurisë për stabilitetin rajonal. Në të njëjtën kohë, zyrtarët e Brukselit ia kanë kaluar madje edhe vetvetes në përpjekjet për të shpjeguar që EULEX-i është një mision “neutral ndaj statusit” dhe një operacion teknik i cili nuk është i mandatuar për ta jetësuar planin e Ahtisaarit.

Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO) ka qenë aktive dhe funksionale në Kosovë që nga fillimi i mandatit të saj. Kjo është duke hapur zyrat rajonale anembanë Kosovës dhe është po ashtu aktive, ani pse jo edhe e pranishme, në veri. Veprimi i saj në terren ka qenë mbresëlënës, duke e patur parasysh atë që as UNMIK-u, as misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), dhe as Këshilli i Evropës, nuk e kanë ndonjë marrëdhënie formale me të. Si i vetmi institucion i cili haptas e përkrah pavarësinë e Kosovës, ICO-ja, së bashku me KFOR-in, e gëzon legjitimitetin më të lartë nga institucionet ndërkombëtare në Kosovë. Aktivitetet e ICO-së nuk kanë qenë së tepërmi publike, por kanë qenë efikase në punën e tyre me institucionet e Kosovës.<sup>25</sup> Testim për suksesin e ICO-së do të jetë zbatimi i decentralizimit dhe krijimi i komunave të reja, në veçanti krijimi i komunës së Mitrovicës Veriore. Pa përkrahjen e qartë, konkrete dhe të plotë të SHBA-ve, dhe veçmas të EU-së, është vështirë që do të ketë gjasa që misioni do t'i përmbushë objektivat e veta të shpallura, e në të cilin rast shtetësia dhe integriteti territorial i Kosovës do të jenë të rrezikuara.

Ka gjithnjë e më pak kohë për rikonfigurimin e pranisë ndërkombëtare në Kosovë. Kaosi ekzistues nuk mund të vazhdojë më tepër se fillimi i vitit 2009. Në vend të zbatimit të planit të Ahtisaarit, Kosovës mund t'i ndodhë fare lehtë që veten ta gjejë në prag të dështimit të shtetit. Për më tepër, Qeveria e Kosovës nuk do të jetë e gatshme për të ecur përpara me zbatimin e propozimit të Ahtisaarit, nëse UNMIK-u vazhdon t'i drejtojë çështjet administrative dhe ato të sundimit të ligjit në zonat e banuara me serbë.<sup>26</sup> Elementet vendimtare të planit të Ahtisaarit mund të dështojnë nëse veriu mbetet jashtë orbitës së Prishtinës. Autoritetet ndërkombëtare dhe kombëtare nuk e kanë luksin të mbajnë një raund të ri të zgjedhjeve në vitin 2009 pa pjesëmarrjen e serbëve dhe themelimin e komunave të reja. Po të ndodhë kjo, veriu i Kosovës do të shndërrohet, në rastin më të mirë, në një “konflikt të ngrirë” dhe parajsë për krimin e organizuar, ndërkohë që pjesa e mbetur e serbëve do ta humbin përsëri mundësinë për një përfaqësim legjitim dhe legal, si dhe për ta marrë të ardhmen e tyre në duart e veta. Ata do ta humbisnin, po ashtu, edhe besimin për një jetë të qëndrueshme dhe prosperuese nëpër enklava, dhe do të ndodhë një valë e re e heshtur e imigrimit. Kosovës veriore nuk mund t'i jipet roli i mbajtjes peng, si të Prishtinës, ashtu edhe të pjesës së mbetur të serbëve.

### **III. Pasojat e shkatërrimit socio-ekonomik**

Zona e Mitrovicës së Jugut, Veriut dhe komuna e Zveçanit, kanë qenë një komunë e vetme dhe një zonë e vetme ekonomike në të kaluarën, dhe këto janë zhvilluar përreth

<sup>25</sup> Intervistat e KIPRED-it me zyrtarë të Qeverisë së Kosovës dhe të ICO-së, shtator/tetor 2008.

<sup>26</sup> Intervistë e KIPRED-it në Ministrinë e Qeverisë Lokale, 13 tetor 2008.

kompleksit xehetar industrial të Trepçës dhe të fabrikave të saj përpunuese. Trepça ishte prodhuesi më i madh i plumbit, zingut dhe i akumulatorëve në ish-Jugosllavinë socialiste.<sup>27</sup> Në vitin 1989, kompleksi i Trepçës i punësonte përafërsisht rreth 10,000 punëtorë nga rajoni i Mitrovicës, nga të cilët 6,500 ishin shqiptarë të Kosovës, rreth 3,000 serbë të Kosovës, dhe 400 të tjerë,<sup>28</sup> duke e dhënë kështu punësimin më të madh në këtë zonë. Në vitin 2008, 1,365 shqiptarë dhe 1,200 serbë punonin në mbetjen e kompleksit të Trepçës.<sup>29</sup> Ashtu siç European Stability Initiative (ESI) e ka theksuar me të drejtë, në Evropën Juglindore nuk ka asnjë shembull të ndonjë vendi i cili vuan njëkohësisht aq sa ky, edhe nga tensionet e pazgjidhura etnike, dhe edhe nga pasojat e de-industrializimit, dhe “askund tjetër kombinimi i këtyre dyjave nuk e ka krijuar një krizë shoqërore dhe ekonomike aq të vrazhdë sa në komunat binjake të Mitrovicës dhe të Zveçanit në Kosovën Veriore.”<sup>30</sup>

Sot, shkalla e papunësisë në Mitrovicën e Jugut, e cila e ka një popullatë prej përafërsisht 66,000 është 60%; shumica e 19,674 të punësuarve janë në sektorin privat, ndërkohë që buxheti i Kosovës i mbështet përafërsisht 4,000 të punësuar dhe ofron transfere shoqërore për 8,000 njerëz.<sup>31</sup> Për Mitrovicën Veriore dhe për Zveçan nuk ka të dhëna të mjaftueshme. Sipas vlerësimeve, shumica e të hyrave në Mitrovicën veriore dhe në Zveçan vijnë nga buxheti i Serbisë, i cili i mbështet 4,100 të punësuar dhe ofron transfere shoqërore për 2,400 njerëz,<sup>32</sup> në një zonë me përafërsisht 24,000 banorë.

Situata socio-ekonomike është një kërcënim për paqen dhe stabilitetin në rajonin e Mitrovicës. Deri më 1989, Mitrovica ishte një nga qytetet më përparuar në Kosovë, me një strukturë stabile shoqërore përgjatë vijave etnike, dhe me një shoqëri në masë të madhe laike. Ky mjedis shoqëror u shkatërrua në fazë, duke filluar heret në vitet 1990, kur praktikisht të gjithë punëtorët shqiptarë nga autoritetet e Beogradit u dëbuan nga sektori publik, pastaj varfëria e përnjëhershme e cila e goditi këtë zonë, duke kulmuar me luftën e vitit 1998-99, dhe me një ndarje efektive të qytetit më pas. Kompleksi i Trepçës është shkatërruar pothuaj në tërësi jo vetëm për shkak të kohës së de-industrializimit e cila e goditi ish botën komuniste, por po ashtu për shkak të menaxhimit jashtëzakonisht të dobët nga qeveria e Serbisë. Shpresat e shqiptarëve lokalë për prosperim ekonomik u tretën në 1999/2000, kur e kuptuan që ata nuk do të jenë në gjendje të kthehen në vendet e tyre të mëparshme të punës në kuadrin e kompleksit industrial të Trepçës.

---

<sup>27</sup> Kosovo Municipalities – Short Profile – Association of Kosovo Municipalities, fq. 72. Prishtinë, qershor 2008.

<sup>28</sup> Trepca 1965-2000, LLA/ESI report 2003, fq. 16, [http://www.esiweb.org/pdf/esi\\_document\\_id\\_62.pdf](http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_62.pdf)

<sup>29</sup> Intervistë e KIPRED-it me Naip Zekën, Kryesues i Bordit Udhëheqës të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Qeveria e Kosovës, 17 tetor 2008.

<sup>30</sup> People or territory? A proposal for Mitrovica. ESI, shkurt 2004.

[http://www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=156&document\\_ID=50](http://www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=156&document_ID=50)

<sup>31</sup> Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2009-2011, Kuvendi Komunal i Mitrovicës, fq. 17-18. Shtator 2008.

<sup>32</sup> Këto shifra janë për vitin 2004; KIPRED-i vlerëson që sot ky numër është më i lartë. Mitrovica: Kosovo's Litmus Test. Punim Diskutimi, fq. 6, ESI, 26 prill 2006.

[http://www.esiweb.org/pdf/esi\\_document\\_id\\_75.pdf](http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_75.pdf)

Serbët, nga ana tjetër, veten përnjëherësh e panë të varur në tërësi nga Beogradi dhe nga strukturat që në qytet u sponsoruan nga ai dhe të zënë në kurthin e tij, duke mbetur pa ndonjë perspektivë realiste për ndonjë zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Veriu është një shembull i mahnitshëm i limiteve të asaj që ofrojnë strukturat paralele. Strukturat paralele të Serbisë e kanë ndërprerë tranzicionin e kësaj zone nga varshmëria nga të hyrat shtetërore në një ekonomi të tregut të lirë. Kjo varshmëri është arsyeja kryesore pse e kemi një pamje të kohezionit në mesin e serbëve në veri, dhe pse nuk ka zëra publik që e kundërshtojnë mbërthimin nga Beogradi. Është ky prizmi përmes të cilit duhet po ashtu të vlerësohet situata në veri.

Një numër i konsiderueshëm i banorëve të Mitrovicës në vitet e fundit kanë kaluar nga sekularizmi në një jetë shoqërore të organizuar përreth fesë. Elemente të huaja islamike për Mitrovicën janë përhapur në vitet e vonshme të 90-ve, kur elementet radikale islamike u instaluan nga Shërbimi i Sigurisë Shtetërore të Serbisë (DB).<sup>33</sup> Pas luftës, elemente të ndryshme islamike e gjetën një vend të plleshëm për rritjen e tyre. Në veçanti të suksesshëm ishin vahabistët që e kanë shfrytëzuar varfërinë e skajshme për t'i mbushur radhët e tyre, kryesisht duke u ofruar individëve përfitime financiare në vlerë €300-€400 në muaj.<sup>34</sup> Vahabistët ishin në vijat e para në Mitrovicë gjatë rebelimit të vitit 2004.<sup>35</sup> Udhëheqësia lokale dhe Qeveria e Kosovës, edhe pse privatisht të alarmuar, janë treguar shpërfillëse dhe të paafta për t'u marrë me këtë dukuri. Në vend të kësaj, shumë besojnë në një mënyrë jorealiste që kjo çështje do të zhduket thjesht vetvetiu. Pa zhvillim ekonomik dhe pa luftë kundër varfërisë, ekstremizmi fetar dhe radikalizmi etnik do të vazhdojnë të rriten, dhe kurfarë zgjidhjesh sipërfaqësore afatshkurtëra nuk do të jenë të realizueshme pa mjete për një jetë me prosperitet.

#### **IV. Zgjidhja në faza për rrugën e mëtutjeshme**

Komunat e Mitrovicës Jugore, Mitrovicës Veriore dhe të Zveçanit e paraqesin një zonë të vetme të rrënuar, ku presionet ndëretnike përplasen drejtpërdrejt. Pas konsultimeve të gjata me të gjitha palët e përfshira, KIPRED-i për këtë zonë e propozon një zgjidhje të zhvillimit politik dhe ekonomik në faza, e cila e parashtron një mundësi për stabilizimin, edhe për vetë zonën, edhe për Kosovën në tërësi.

Në zhvillimin e këtij propozimi, KIPRED-i i ka marrë parasysh edhe Parimet Udhëzuese të Grupit të Kontaktit për integritetin territorial të Kosovës, edhe propozimin e Ahtisaarit, si zgjidhjen më të qëndrueshme politike. KIPRED-i ia shton kësaj zgjidhjen politike dhe paketin e zhvillimit ekonomik për veriu, si një zgjidhje "Ahtisaari Plus". Ky propozim ka tri faze – i) vendosja complete e sundimit të ligjit; ii) zbatimi i suksesshëm i decentralizimit në veri; dhe iii) zbatimi i "pakos ekonomike". Ky është një paket i pandashëm, i cili nuk mund të zbatohet pjesërisht, dhe kushtëzohet me zbatimin e plotë të

---

<sup>33</sup> Intervistë e KIPRED-it me një ish-diplomat jugosllav, shtator 2008.

<sup>34</sup> Intervistat e KIPRED-it me aktivistë të shquar të komunitetit në Mitrovicë dhe me një këshilltar të Bajram Rexhepit, shtator/tetor 2008.

<sup>35</sup> Fjala e Bajram Rexhepit në Simpoziumin Politik të Forumit Alpbach në Austri, nga 24 deri më 26 gusht, 2008.

çdo faze. Zbatimi i këtyre fazave duhet të filloj në nëntor 2008 dhe të përfundojë më mesin e vitit 2010.

### **Faza 1 – Vendosja e sundimit të ligjit**

- Përmbyllja e suksesshme e dislokimit të plotë dhe funksional të EULEX-it në Kosovën veriore, me përkrahje aktive nga UNMIK-u dhe KFOR-i.
- Rihapja e shërbimit të doganave në vendkalimet kufitare 1 dhe 31, dhe ushtrimi efektiv i regjimit kufitar.
- Zgjidhja e statusit të policisë së Kosovës në veri.
- Strukturat paralele të sigurisë të Beogradit të shpërndahen në tërësi.

### **Faza 2 – Zbatimi i decentralizimit**

- Forca e posaçme për zbatimin e decentralizimit në veri të krijohet dhe të funksionojë deri në prill 2009.
- Qeveria e Kosovës dhe komuniteti i donorëve ta krijojnë një “fond të besimit” për zhvillim infrastrukturual dhe për rindërtim që e kap vlerën prej €30 - €50 milionë për komunat e Mitrovicës së Jugut, Mitrovicës së Veriut dhe Zveçanit.
  - Kjo shumë duhet të jetë në dispozicion të komunave gjatë afatit të tyre të parë 4-vjeçar.
  - “Fondi i besimit” duhet të bëhet në tërësi operacional pas zgjedhjeve komunale, dhe duhet të menaxhohet nga ICO-ja dhe përfaqësuesit e tri komunave.
- Organizimi i zgjedhjeve të suksesshme komunale dhe krijimi i udhëheqësisë legale dhe legjitime të serbëve të Kosovës, nëntor 2009.
- Policia e UNMIK-ut duhet t’i bartë kompetencat e veta formale në Shërbimin Policor të Kosovës në rajonin e Mitrovicës.
- Raundi i parë i privatizimit në këtë periudhë duhet të përqendrohet në privatizimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore anëmbanë veriut, duke e nxitur pjesëmarrjen e plotë të serbëve të Kosovës.
- Qeveria e Kosovës dhe komuniteti i donorëve duhet t’i përkrahë OJQ-të lokale në veri në jetësimin e projekteve multi-etnike.

### **Faza 3 – Jetësimi i “zonës së veçantë të investimeve”, “zonës së lirë nga doganat” dhe “studimit të veçantë i ambiental”**

#### **“Zona e veçantë e investimeve”**

- Do t’i përfshijë territoret e tri komunave – Mitrovica Jugu, Mitrovica Veriu dhe Zveçani.

- Qëllimi i krijimit të kësaj zone është të ofrohet një mjet i qëndrueshëm për ripërtëritjen ekonomike për zonën e de-industrializuar dhe vënia në jetë e nxitjeve joshëse për investimet e jashtme dhe vendëse të drejtpërdrejta, dhe për punësimin e vrullshëm të të gjitha komuniteteve.
- Kjo zonë duhet të mbikëqyret nga një trup i veçantë që do të përbëhet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe nga përfaqësuesit e të tri komunave.
- Kompanitë që i zhvillojnë aktivitetet e tyre ekonomike në këtë zonë do të jenë të liruara nga pagesa e:
  - a. Taksave komunale (lejet, taksat në pronë, etj);
  - b. Taksave në fitim, të nivelit qendror.
- Kompanitë do të duhen të paguajnë të gjitha taksat e tjera (taksa në të hyra, kontributet e punës dhe taksës në të ardhura personale, dhe TVSH).
- Qeveritë komunale në bashkëpunim me Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë (MTI) dhe Qeverinë qendrore duhet ta promovojnë këtë zonë për industrinë e punësimit intenziv.
- Në këtë aspekt autoritetet komunale duhet të ofrojnë tokën pa pagesë në këmbim për punësim dhe plane të përshtatshme të investimeve për një periudhë afatmesme.

### **“Zona e lirë nga doganat”**

- Kjo zonë do të ndodhet midis hekurudhës dhe pikëlidhjes së lumenjve Ibër dhe Sitnicë, për shkak të vendndodhjes së saj gjeografike (trekëndëshi midis tri komunave) dhe meqë infrastruktura e kërkuar tashmë është aty.
- Ky vend ka hapësirë të mjaftueshme dhe kushte optimale për kontrollimin dhe menaxhimin e prodhimit dhe të shërbimeve të biznesit nga të gjitha komunitetet e rajonit të Mitrovicës;
  - a. Pa taksa korporate dhe të fitimit;
  - b. Zona do të shfrytëzohet për prodhim, qëllime të tregtisë dhe të transportit;
  - c. Të mirat mund të importohen pa taksa dhe dogana;
  - d. Importimi i pajisjeve dhe makinave të reja për qëllime të prodhimit do të jetë i lirë nga doganat nëse do të shfrytëzohet në “zonën e lirë nga doganat”;
  - e. Çfarëdo tarifash që do të gjenerohen në këtë zonë do t’i jipen “fondit të besimit”.
- Kjo zonë do të mbikëqyret nga EULEX-i, Shërbimi Doganor i Kosovës, MEF-i dhe përfaqësuesit e të trija komunave.

### **“Studimi i veçantë ambiental”**

- Për shkak të praktikave të gjata në industri dhe xehtari, toka dhe ujërat e kësaj zone janë të ndotura. Për këtë arsye studimi i gjendjes së tokës dhe ujërave është i një rëndësie shumë të madhe, duke e marrë parasysh sasinë e lartë të plumbit në

këtë zonë. Është e një rëndësie të veçantë krijimi i kushteve për zhvillimin e bujqësisë në këtë zonë.

Vërejtje:

*Këto rregullime do të zgjasin deri sa Kosova ta nënshkruaj traktatin për hyrje me Unionin Evropian.*